



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PROFESIONAL – TEKNIK (APT)**

PROGRAMI I LËNDËS

**HISTORI
Klasa e 10-të**

STRUKTURA e APT: 2+1+1 vite, 2 + 2 vite, bllok 4-vjeçare

DREJTIMI i APT: Të gjitha drejtimet e arsimit profesional-teknik

Koordinatori: EVIS MASTORI

Redaktori: GAZMEND KRASNIQI

Përgjegjës sektori: MARITA HAMZA

TIRANË, KORRIK 2010

Programi “Historia e qytetërimit botëror”, studion aspektet e jetës shoqërore, si shteti, ligji, zhvillimi ekonomik, shoqëria, kultura materiale dhe shpirtërore, si dhe veprimtaritë e jetës së përditshme, duke vendosur një raport të barabartë midis këtyre fushave të jetës. Përvoja njerëzore, e vendosur nga programi në një kornizë historike tematike, nuk paraqitet e kufizuar vetëm në një aspekt të jetës, si në programet e mëparshme, por trajton probleme që lidhen me qytetërimin, duke filluar nga elementet e jetës së përditshme, pra nga mënyra e jetesës, e deri te sistemet ekonomike, politike e kulturore.

Historia e qytetërimit botëror ka për qëllim, përgatitjen e nxënësve për të qenë qytetarë të informuar të botës, të aftë për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, si dhe të aftë për të kuptuar të kaluarën, të sotmen dhe perspektivat e së ardhmes.

Programi “Historia e qytetërimit botëror” trajton ngjarjet historike në vazhdimësi kronologjike, e cila mundëson lidhjen e brendshme e të jashtme midis periudhave dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimin botëror.

Në klasën e 10-të të arsimit profesional, programi “Historia e Qytetërimeve në antikitet dhe në mesjetë”, si pjesë e Historisë së Qytetërimeve Botërore, trajton qytetërimet e zhvilluara në luginat e lumenjve dhe në brigjet detare mesdhetare, veçoritë e zhvillimit, bashkëveprimin, si dhe ndikimin e tyre mbi qytetërimet e mëvonshme. Ai përfshin dhe qytetërimin mesjetar, duke pasqyruar tipologjinë e këtij qytetërimi, i njohur ndryshe dhe si “epoka e errët” e qytetërimit botëror.

Ky program shpreh risi për problematikën që ai sjell dhe mënyrën e trajtimit, në krahasim me kurrikulën e mëparshme të arsimit të mesëm. Ai synon që të krijojë te nxënësit bindjen se qytetërimi i sotëm është një vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak – pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike.

Trajtesa tematike shpreh natyrën përzgjedhëse (selektive) të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë gjithë ngjarjet e historisë së qytetërimit botëror, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Trajtesa tematike synon gjithashtu vendosjen e një balance historike mes kontributeve të shoqërive në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimit botëror, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, t’i analizojë ato në mënyrë kritike, duke bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes. Programi shpalos hapësira që i japin mundësi nxënësit për t’u përfshirë në ato fusha ku ai dëshiron të thellohet.

1. SYNIMI I LËNDËS

Lënda “Historia e qytetërimit botëror” synon:

- Të aftësojë nxënësit për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën, për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen dhe me perspektivat e së ardhmes, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike.
- Të zhvillojë aftësitë intelektuale të nxënësit për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut,

kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur sidomos për çështjet të ndjeshme historike.

- Të aftësojë nxënësit për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale duke ju mundësuar atyre të ndërtojnë identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët.
- Të ngrejë vlerat themelore të qytetarisë, si tolerancën, mirëkuptimin, të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi, nxënësi/ja:

- Të përshkruajë momentet më kulmore të zhvillimit të shoqërisë, nëpërmjet një trajtimi kronologjik tematik.
- Të përshkruajë përvojën historike të shoqërisë, për të kuptuar më mirë jetën aktuale dhe për të qenë i/e aftë të projektojë të ardhmen, duke nxitur të menduarin në mënyrë kritike.
- Të interpretojë shoqërinë njerëzore në të kaluarën, për të kuptuar të sotmen dhe ndikimin e tyre në zhvillimet historike të së ardhmes.
- Të zhvillojë aftësitë për të kuptuar perspektivat e ndryshimeve historike, në një botë në ndryshim.
- Të interpretojë efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes.
- Të edukohet me ndenjen e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë.
- Të argumentojë vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli.
- Të vlerësojë pozitën e qytetërimit shqiptar brenda qytetërimit botëror.
- Të forcojë ndenjen e identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.
- Të kryejë punë kërkimore, duke u bazuar në burime historike, për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë.
- Të edukohet me frymën argumentuese përballë tezave të ndryshme rreth një fenomeni historik.
- Të tregojë lidhjen e vlerave pozitive, si toleranca dhe respektimi i dallimeve ndërmjet kulturave të ndryshme, përmes studimit të historisë.
- Të zhvillojë, përmes studimit të historisë, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen personale si individ, në përgatitjen për jetën, punën dhe shoqërinë.
- Të përcaktojë detyrimet dhe përgjegjësitë në kuadrin e shtetit ligjor, të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të individit, nëpërmjet pajisjes me kulturë të plotë demokratike.

3. OBJEKTIVA

a) Linja : Qytetërimi në parahistori

Përshkrimi i linjës: Përmes kësaj linje nxënësit prezantohen me kuptimin dhe vlerat që ka historia e qytetërimit botëror. Nxënës/i-ja do të kuptojë dhe analizojë ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak - pasojë, rolin që ka luajtur mjedisi në zhvillimin e qytetërimeve si dhe ndryshimet fizike, ekonomike, sociale dhe kulturore që pësoi njeriu në parahistori. Ai/ajo do të kuptojë veprimtarinë e historianit në punë nëpërmjet veprimtarive praktike.

Veprimtaritë praktike kanë për qëllim të vendosin nxënësin në pozitën e një historiani, si një zbulues (eksplorues) dhe mbledhës faktesh e dokumentesh, përzgjedhës, gjurmues (hulumtues) e vlerësues, i aftë për të mbajtur qëndrimin e tij për ngjarje të ndryshme historike, duke u bazuar në burime historike.

Orë të sugjeruara¹: 4

¹ Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara, sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit), që të shtojë ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10%, sipas nevojave të klasës.

Nënlinja	Përmbajtje e sugjeruar ²	Objektiva
Historia e qytetërimit	<p><i>Kuptimi mbi historinë e qytetërimit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ç'kuptojmë me qytetërim. • Periodizimi i parahistorisë. • Shoqëria parahistorike veprimtaria e njeriut (Homosapiens) mbi natyrën si një proces evolutiv dhe pasojat që solli. • Besimi dhe artet në parahistori. 	<p>Në përfundim të klasës së 10-të, nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë konceptet historike kyçe: histori qytetërimi, qytetërim, burime, periodizim, dokumente, mjedis, paleolit, mezolit, neolit, hominid, homosapiens, epokë akullnajore, parahistori, shoqëri parahistorike. • të shpjegojë kuptimin e nocionit qytetërim; • të analizojë objektin e historisë së qytetërimit; • të evidentojë tërësinë e vlerave materiale dhe shpirtërore të krijuara nga qytetërimet në zhvillimin historik të tyre. • të vlerësojë drejt ndikimin e mjedisit në zhvillimin e një qytetërimi; • të tregojë epokat parahistorike, duke identifikuar shtrirjen kohore të tyre; • të përshkruajë ndryshimet që pësoi njeriu gjatë evolucionit të tij; • të analizojë veprimtaritë e njeriut që çuan në krijimin e komuniteteve të para njerëzore; • të shpjegojë veprimtaritë e para ekonomike, zhvillimin e mendimit, të besimit e të artit dhe të komuniteteve të hershme njerëzore, si pikënisje e qytetërimit botëror; • të vlerësojë epërsitë që solli ndarja e punës dhe përdorimi i metaleve në zhvillimin e shoqërisë njerëzore.
	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara³:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi kronologjik i 	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë periudhat historike: <ul style="list-style-type: none"> - Antikitët, - Mesjetë, - Moderne (moderne e hershme 1500 – 1815)

² Përmbajtjet e sugjeruara janë çështje mësimore të rekomanduara nga specialistët, për të orientuar hartuesit e tekstit të lëndës, në zbatimin e objektivave lëndorë. Ato nuk përfaqësojnë një njësi ore mësimore. Quhen të sugjeruara, pasi hartuesit e tekstit mund të zvogëlojnë ose të zgjerojnë hapësirën e çështjeve mësimore të sugjeruara, por ata duhet të zbatojnë me rreptësi përmbajtjen e objektivave të nënlinjave.

³ Veprimtari praktike të sugjeruara janë orë praktike në funksion të përpunimit dhe thellimit të njohurive të reja, si dhe të aftësimit praktik të nxënësve. Janë të sugjeruara, sepse përdoruesit e programit (hartuesit e tekstit dhe mësuesit) mund t'i ndryshojnë këto veprimtari të sugjeruara, në funksion të nevojave të përpunimit të lëndës dhe të përshtatjes së këtyre veprimtarive me ngjarjet e reja në kohë. Përdoruesit e programit mund të përzgjedhin ato veprimtari që i mendojnë më të përshtatshme, për përpunimin e objektivave të linjës dhe të nënlinjës.

	<p>historisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Llogaritja e kohës (pr. K; ps. K), llojet e kalendarëve dhe periodizimi i historisë. • Puna me dokumente historike • (arkiv, bibliotekë, muze). • Gjurmë të parahistorisë në vendin tonë. Popujt që kanë populluar në lashtësi Ballkanin. • Kushtet historike që ndikuan në kalimin e organizimit shoqëror e drejtimin e tij, nga gruaja te burri. 	<p>dhe moderne 1815 – 1945</p> <p>- Bashkëkohore 1945 – sot ;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojë organizimin kronologjik të historisë, me qëllim vendosjen e ngjarjeve dhe të njerëzve në periudha të ndryshme historike, për të shpjeguar marrëdhëniet historike; • të kryejë veprime për llogaritjen e kohës; • të ndërtojë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike; • të përdorë një gjerësi burimesh historike dhe informacioni të duhur, duke përfshirë dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, media, piktura, muze, galeri, fotografi, muzikë dhe internetin si bazë hetimi vetjak, për ndërtimin dhe argumentimin e një ngjarjeje historike; • të evidentojë, nëpërmjet burimeve alternative, gjurmë të parahistorisë në vendin tonë dhe të identifikojë popujt, që kanë populluar në lashtësi Ballkanin; • të shpjegojë dallimet mes shoqërisë matriarkale dhe asaj patriarkale.
--	--	---

b) Linja: Qytetërimet botërore në antikitet
(Mijëvjeçari IV pr. K. – shek. V ps. K.)

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë përshkruan dhe analizon kushtet, etapat dhe tiparet ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të qytetërimeve antike në Mesopotami, Egjipt, Greqi e Romë. Nëpërmjet njohurive të marra në këtë linjë, nxënësit i krijojnë mundësinë të analizojë zhvillimet e qytetërimeve në brigjet e lumenjve në plan krahasues me qytetërimet në brigjet e deteve mesdhetare, për të kuptuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve. Kjo linjë i pajis nxënësit me njohuri dhe shprehje për të evidentuar tiparet e përbashkëta dhe veçantitë e shoqërive në lashtësi.

Orë të sugjeruara: 16



Nënlinja	Përmbajtje e sugjeruar	Objektiva
Qytetërimet e hershme. (Mijëvjeçari IV – II pr. K)	<p><i>Lindja e qytetërimeve të hershme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Harta e qytetërimeve të hershme. • Veçoritë e zhvillimeve ekonomike, tipare të përbashkëta të ekonomisë së Mesopotamisë dhe të Egjiptit. 	<p>Në përfundim të klasës së 10-të, nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë termat dhe konceptet historike kyçe, si: qytetërim, mbeturina lumore, kodet, pushtet hyjnor, pushtet i dhuruar nga zoti, kavaleri, shpikje, shkrimi, politeizmi, monoteizmi, piramida, mumie, barbarë, koloseumi; • të vlerësojë rolin e figurave kryesore historike në këtë periudhë, si, p.sh.,: Sargoni, Hamurabi, Menesi, Ramsesi II; • të tregojë në hartë vendndodhjen e të gjitha qytetërimeve, që lindën në brigjet e lumenjve; • të përcaktojë kohën e lindjes së qytetërimeve në Mesopotami dhe në Egjipt; • të shpjegojë rolin e mjedisit gjeografik në evolucionin e qytetërimeve në Mesopotami dhe në Egjipt; • të përshkruajë tiparet ekonomike të Mesopotamisë dhe të Egjiptit; • të krahasojë veçoritë ekonomike të Mesopotamisë dhe të Egjiptit.
	<p><i>Shteti dhe shoqëria, në Mesopotami</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi shoqëror në Mesopotami.; • Lindja e shtetit dhe veçoritë e tij në Mesopotami, Hamurabi dhe kodet e tij. <p><i>Shteti dhe shoqëria, në Egjipt</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i shoqërisë në Egjipt, ndërtimi piramidal i shoqërisë egjiptiane. • Lindja e shtetit dhe veçoritë e tij në Egjipt. 	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë ndërtimin shoqëror në Mesopotami dhe në Egjipt, duke krahasuar veçoritë e tyre; • të identifikojë tiparet e organizimit shtetëror dhe karakterin e tij në Mesopotami dhe në Egjipt; • të analizojë, nëpërmjet krahasimit, rolin e monarkut si “pushtet zot” dhe “pushtet i dhuruar nga zoti”, duke nxjerrë përfundime mbi këtë çështje; • të shpjegojë karakterin dhe rolin e ligjeve të Hamurabit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në Mesopotami; • të analizojë kodin e Hamurabit;

	<p><i>Kultura dhe besimi në qytetërimet e hershme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Kultura, shkrimi dhe besimi në qytetërimet e hershme 	<ul style="list-style-type: none"> • të analizojë kulturën materiale e shpirtërore të qytetërimeve të hershme; • të argumentojë ndikimin e arritjeve të këtyre qytetërimeve në jetën e sotme.
	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Enigma e piramidave. 	<ul style="list-style-type: none"> • të kërkojë, të grumbullojë dhe të përzgjedhë materiale për piramidat, duke diskutuar në klasë enigmat e tyre.
<p>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut</p>	<p><i>Lindja dhe përhapja e qytetërimeve në brigjet e deteve të Mesdheut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohja me popujt e detit, lokalizimi në hartë (Fenikia, Kreto – Mikena, Greqia, Roma, Iliria). • Mjedisi dhe zhvillimi i këtyre qytetërimeve. • Qytetërimi kretomikenas dhe etrusk si pararendës i qytetërimit grek dhe romak. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë termat dhe konceptet historike kyçe, si: popuj të detit, shkrim fenikas, mure ciklopikë, qytet-shtet, koloni, luftë civile, oligarki, demokraci, tirani, patrikë, plebenj, skllavopronarë, gladiator, perandori, stil dorik, jonik e korintik, hark triumfi, obelisk, politeizëm, letërsi, filozofi, art, arkitekturë, krishterim, dyndje, migrim, krizë, shtete romane-gjermanike; • të vlerësojë rolin e figurave historike kryesore në këtë periudhë, si, p. sh.: Homeri, Soloni, Dragoni, Perikliu, Romuli, Remi, Jul Çezari, Oktaviani, Spartaku, Krishti, Konstandini i Madh, Teodosi, Atila; • të përcaktojë në hartë vendosjen dhe shtrirjen e popujve të detit. (Fenikia, Kreto – Mikena, Greqia, Roma, Iliria); • të përcaktojë kohën e lindjes së qytetërimeve në Feniki, Kreto-Mikenë, Greqi, Romë dhe në Iliri; • të analizojë ndikimin e mjedisit në zhvillimin e këtyre qytetërimeve; • të argumentojë ndikimin e qytetërimit kretomikenas dhe atij etrusk në qytetërimin grek e romak.

	<p><i>Shteti dhe ligji në Greqinë antike:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Evolucionin politik i qytet-shteteve greke: nga mbretëria në republikën oligarkike, demokratike dhe tirani. • Lidhjet midis qytet – shteteve. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë evolucionin politik të qytet – shteteve greke të Athinës dhe të Spartës; • të vlerësojë demokracinë antike dhe ndikimin e saj në qytetërimet e mëvonshme; • të diskutojë për karakterin e lidhjeve të qytet – shteteve greke.
	<p><i>Shteti dhe ligji në Romën antike:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Evolucionin politik i Romës, nga monarkia në republikë dhe perandori. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë evolucionin politik të Romës; • të analizojë krijimin e së drejtës romake si një prej legjislacioneve më të rëndësishme të jurisprudencës botërore; • të krahasojë evolucionin politik të institucioneve greke dhe romake, duke argumentuar ndryshimet mes tyre.
	<p><i>Shoqëria dhe jeta e përditshme në qytetërimin antik grek dhe romak:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet e organizimit shoqëror në qytetërimin grek e atë romak, përshkrimi i jetës së përditshme, si : veshja, ushqimi, mobilimi i shtëpive, martesat, zakonet etj. • Roli i femrës në këto shoqëri, të drejtat e tyre ligjore. 	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë tiparet e organizimit shoqëror në qytetërimin grek e atë romak; • të dallojë nëpërmjet ilustrimeve elemente të jetës së përditshme në qytetërimin grek e atë romak; • të evidentojë rolin e gruas në qytetërimin grek e atë romak.

	<p><i>Arti , kultura dhe shkenca në qytetërimin antik grek e atë romak dhe përhapja e tyre:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet e artit, të kulturës, shkencës dhe të arsimit në qytetërimin grek e romak. • Përhapja e kulturës greke e romake. • Krijimi i kolonive, kultura helenistike, zgjerimi i perandorisë romake. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë në hartë përhapjen e qytetërimin grek e romak; • të përdorë saktë konceptin koloni greke; • të evidentojë rrugët nëpërmjet të cilave u përhapën këto qytetërimet; • të përshkruajë tiparet e artit, të kulturës, të shkencës dhe të arsimit në qytetërimin grek e atë romak; • të krahasojë tiparet e kulturës greke me atë romake.
	<p><i>Besimi në lashtësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet e besimit në lashtësi. • Kushtet historike të lindjes së krishterimit, veçoritë e tij dhe institucionet kishtarë. 	<ul style="list-style-type: none"> • të tregojë veçoritë e besimit hebre dhe pagan; • të analizojë kushtet e lindjes së krishterimit, duke evidentuar rrethanat historike të kalimit nga besimi pagan në atë të krishterë; • të argumentojë faktorët historikë që ndikuan në përhapjen e krishterimit.
	<p><i>Ndërprerja e qytetërimin antik në Evropë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Popujt që migruan në territorin e Perandorisë Romake, niveli i zhvillimit të tyre, pasojat që sollën. • Tiparet e shoqërisë romake pas dyndjeve të popujve. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë në hartë shtrirjen e “dyndjeve të popujve” në Evropë; • të përcaktojë faktorët historikë që shkaktuan lëvizjen e popujve; • të analizojë pasojat që sollën migrimet e popujve në Evropë; • të vlerësojë rolin e migrimet të popujve në ndërprerjen e qytetërimin antik dhe lindjen e qytetërimin mesjetar; • të analizojë shkaqet e ndërprerjes së qytetërimin antik në Evropë.
	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e Perandorit romak Konstandin.. • Marrëdhëniet midis qytetërimeve të lashta. (Martesa e Kleopatrës me Mark Antonin.). • Jetë paralele, Perikliu 	<ul style="list-style-type: none"> • të argumentojë përfitimet e ndërsjella ndërmjet kulturave të qytetërimeve antike; • të argumentojë marrëdhëniet ekonomike, politike dhe kulturore ndërmjet qytetërimin ilir dhe atij romak; • të vlerësojë rolin e figurave historike në zhvillimin e shteteve.

	dhe Augusti. <ul style="list-style-type: none">• Demokracia athinase dhe tiparet e shtetit të sotëm demokratik.	
--	---	--

c) Linja: Qytetërimet botërore në mesjetë (Shek. V – shek. XV)

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë ka për qëllim të shpjegojë dhe analizojë etapat kryesore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë mesjetare dhe qytetërimet në mesjetë; të krahasojë mënyrën e organizimit ekonomik, politik, dhe kulturor të këtyre qytetërimeve për të kuptuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve. Nëpërmjet kësaj linje, nxënësi do të kuptojë dhe shpjegojë kalimin nga qytetërimet në lashtësi në qytetërimet mesjetare dhe ndryshimet që pësuan këto qytetërimet.

Orë të sugjeruara: 16



Nënlinja	Përmbajtje e sugjeruar	Objektiva
<p>Qytetërimet botërore në mesjetë. (Shek. V – shek. X)</p>	<p><i>Qytetërimi bizantin:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet e qytetërimit bizantin. • Ardhja e sllavëve në territoret Bizantine, tiparet e reja të qytetërimit bizantin. • Kultura, arti dhe besimi në qytetërimin bizantin. 	<p>Në përfundim të klasës së 10-të, nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë termat dhe konceptet kyçe historike, si: trashëgimi greko-romake, , “epokë e errët”, mesjetë ndarja e kishës, perandori, katolicizëm, ortodoksi, kod, islam, allahu, kalifat, kalif, mysliman, kuran, vend i shenjtë, agjërim; • të vlerësojë rolin e figurave historike kryesore në këtë periudhë, si, p. sh.: Justiniani, Muhamedi, Omar Khajani, Gregori i Madh, Karli i Madh, Leoni III, Otoni I; • të shpjegojë tiparet e qytetërimit bizantin, duke argumentuar shkaqet e krijimit të tij; • të përcaktojë në hartë lëvizjet e sllavëve në Ballkan e Bizant; • të përshkruajë tiparet e organizimit ekonomik dhe shoqëror të qytetërimit bizantin; • të krahasojë tiparet ekonomike dhe shoqërore të qytetërimit bizantin me tiparet ekonomike dhe shoqërore të qytetërimeve të mëparshme; • të japë shembuj nga arti dhe kultura bizantine; • të argumentojë në mënyrë kritike shkaqet e ndarjes së kishës së krishterë.



	<p><i>Shteti dhe ligji në qytetërimin bizantin:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Shtrirja e Perandorisë Bizantine. • Tiparet e organizimit shtetëror në qytetërimin bizantin. • Kodi i Justinianit, momentet e lulëzimit të Perandorisë Bizantine. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë në hartë shtrirjen e perandorisë bizantine. • të analizojë tiparet e organizimit shtetëror të Perandorisë Bizantine; • të shpjegojë karakterin dhe rolin e kodit të Justinianit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në Bizant; • të mbajë qëndrim, duke argumentuar ndikimin e këtij kodi dje dhe sot.
	<p><i>Qytetërimi arab:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet e qytetërimit arab, organizimi shoqëror, ekonomik dhe kulturor. • Kushtet historike të lindjes së besimit islam, përhapja dhe veçoritë e tij. • Organizimi shtetëror: Kalifati. 	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë, me anë të ilustrimit, tiparet e qytetërimit arab; • të evidentojë ndikimin e qytetërimit arab në Evropë; • të demonstrojë në hartë fazat e shtrirjes së Kalifatit Arab; • të analizojë kushtet historike të përhapjes së islamit, duke argumentuar rëndësinë e qytetërimit arab.
	<p><i>Papati dhe Perandoria e shenjtë Romake:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përhapja e krishterimit në Evropë. • Administrata kishtare. • Krijimi i Perandorisë së Shenjtë Romake. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë faktorët që ndikuan në përhapjen e krishterimit në Evropë; • të analizojë rrugën historike të formimit të administratës kishtare. • të argumentojë forcimin e autoritetit papal në Evropë; • të përcaktojë në hartë shtrirjen e Perandorisë së shenjtë Romake; • të analizojë pozitën e Perandorisë së shenjtë Romake. • të argumentojë lindjen e dy autoriteteve në Evropë: Perandori dhe Papa.

	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i një eseje me temë : “Qytetërimi bizantin- vijimësi apo qytetërim i ri?”. • Pozita e vendit tonë midis dy ngjarjeve të mëdha: ndarjes së Perandorisë Romake dhe ndarjes së kishës së krishterë në vitin 1054. Kontributi i shqiptarëve në qytetërimin bizantin. 	<ul style="list-style-type: none"> • të hartojë ese argumentuese me temë “Qytetërimi bizantin-vijimësi apo qytetërim i ri?” ; • të argumentojë, nëpërmjet diskutimit, pozitën e territoreve arbërore midis Romës dhe Bizantit; • të krahasojë dhe të argumentojë qëndrueshmërinë e Perandorisë Bizantine ndaj Perandorisë Romake të perëndimit.
--	--	--



<p>Evolucion i qytetërimeve mesjetare. (Shek. X – shek XV)</p>	<p><i>Ndryshimet në qytetërimin mesjetar evropian:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Feudalizmi në formën e tij klasike. • Tiparet themelore të këtij sistemi: - feudi, aristokracia, vasaliteti, bujkrobëria. • Lindja e qyteteve, zhvillimi i tregtisë, ndryshime në strukturën shoqërore dhe në mënyrën e jetesës. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë termat dhe konceptet historike kyçe, si: feudalizëm, feud fisnikëri, vasalitet, bujkrobëri, vasal, detyrim, qytet, çiflig, luks, konflikte, shtresa shoqërore, komunë, Karta e Madhe e Lirive, monarki e kufizuar, republikë, emancipim, kryqëzatë, ripushtim, sistem feudal-ushtarak, sulltan, spahi, timar, krahina të vetëqeverisura, jeniçer; • të vlerësojë rolin e figurave kryesore historike në këtë periudhë si, psh.: Grigori VII, Henriku IV, Urbani II, Bonifaci VIII, Filipi i Bukur, Xhoni Patokë; • të shpjegojë tiparet themelore të sistemit feudal; • të shpjegojë dhe të analizojë feudalizmin, duke evidentuar ndryshimet në jetën ekonomike dhe shoqërore; • të përshkruajë lindjen e qyteteve dhe zhvillimin e tregtisë në Evropën mesjetare; • të analizojë strukturën shoqërore të Evropës mesjetare, nëpërmjet ilustrimit të një qyteti mesjetar të Evropës; • të krahasojë mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore në Evropën mesjetare.
---	---	--

	<p><i>Marrëdhëniet midis qytetërimit arab dhe atij evropian:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• Marrëdhëniet midis dy qytetërimeve, perëndimor dhe lindor: kryqëzatat, marrëdhëniet tregtare.	<ul style="list-style-type: none">• të shpjegojë marrëdhëniet midis qytetërimit arab dhe qytetërimit evropian, duke evidentuar format e këtyre marrëdhënieve;• të përshkruajë marrëdhëniet tregtare midis qytetërimit arab dhe atij evropian.• të përdorë saktë termin kryqëzatë;• të shpjegojë shkaqet e fillimit të kryqëzatave;• të përcaktojë në hartë itinerarin e lëvizjes së kryqtarëve drejt lindjes;• të analizojë karakterin dhe grupet pjesëmarrëse në kryqëzata si dhe qëllimet e tyre;• të evidentojë pasojat e kryqëzatave në marrëdhëniet mes dy qytetërimeve.
--	--	---



	<p><i>Krijimi i monarkive të centralizuara në Evropë:</i></p> <p><i>Monarkia angleze:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrëdhëniet midis mbretërve dhe lordëve në Angli. • Lindja e parlamentarizmit në Angli. • Karta e Madhe e Lirive. <p><i>Monarkia franceze</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Copëtimi feudal në Francë. • Konflikti midis feudalëve dhe mbretit; • Monarkia absolute. <p><i>Marrëdhëniet midis papëve dhe perandorëve.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimet në autoritetin papal në Evropë. 	<ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë monarkitë kombëtare në hartën politike të Evropës mesjetare; • të shpjegojë procesin e kalimit nga copëtimi feudal në shtet kombëtare, duke analizuar faktorët e këtij procesi; • të shpjegojë marrëdhëniet midis lordëve dhe mbretërve në Angli; • të vlerësojë rolin që mori parlamenti në jetën politike të Anglisë; • të përshkruajë përmbajtjen e Kartës së Madhe të Lirive; • të përcaktojë karakterin e Kartës së Madhe të Lirive, si fillesë historike e monarkisë kushtetuese; • të gjykojë mbi baraspeshimin e pushtetit të mbretit me parlamentin. • të diskutojë për copëtimin feudal në Francë; • të shpjegojë marrëdhëniet hierarkike midis feudalëve dhe mbretërve në Francë, duke analizuar shkaqet e këtyre marrëdhënieve; • të analizojë arsyet e forcimit të pushtetit të mbretit në Francë; • të përshkruajë tiparet e monarkisë absolute në Francë; • të krahasojë rolin e parlamentin anglez me atë të asamblesë së përgjithshme në Francë; • të evidentojë rolin e Papatit në jetën politike të Evropës Perëndimore; • të analizojë pasojat e konfliktit midis pushtetit të papës dhe monarkëve.
--	---	--

	<p><i>Perandoria Osmane – perandori ndërkontinentale:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga selxhukët tek osmanët; etapat e zgjerimit të Perandorisë Osmane. • Organizimi politik dhe zhvillimi ekonomik i Perandorisë Osmane. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë lidhjen midis selxhukëve dhe osmanëve; • të tregojë kushtet historike të formimit të Perandorisë Osmane; • të përcaktojë në hartë shtrirjen e Perandorisë Osmane sipas periudhave të zhvillimit të saj; • të përshkruajë rrugën e krijimit të shtetit osman; • të analizojë karakterin dhe organizimin politik e shoqëror të Perandorisë Osmane.
	<p><i>Kultura në qytetërimin mesjetar:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i arsimit, i artit dhe i kulturës. 	<ul style="list-style-type: none"> • të evidentojë tiparet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit në qytetërimet mesjetare; • të gjykojë për rolin e fesë në qytetërimin mesjetar; • të krahasojë prirjet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit në qytetërimin arab me ato në qytetërimin perëndimor.
	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Trashëgimia e qytetërimeve mesjetare sot. • Lidhja e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV. • Ndarja e kishës-dukuri teologjike apo politike? • Shkëmbimet tregtare, midis botës arabe dhe asaj evropiane. 	<ul style="list-style-type: none"> • të argumentojë trashëgiminë e qytetërimeve mesjetare sot, nëpërmjet diskutimeve, duke iu referuar burimeve historike; • të kërkojë, të grumbullojë dhe të përzgjedhë materiale, për të evidentuar lidhjen e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV; • të shkruajë një ese argumentuese me temë: “Ndarja e kishës- dukuri teologjike apo politike?”; • të kërkojë, të grumbullojë dhe të përzgjedhë materiale, duke diskutuar në klasë për shkëmbimet tregtare midis botës arabe dhe asaj evropiane.

4. KËRKESA TË HISTORISË NDAJ LËNDËVE TË TJERA

HISTORI	MATEMATIKË
Për të gjitha linjat e nënlinjat	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> • të ndërtojë dhe interpretojë grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike. (p. sh., vendosja në tabelë e të dhënave statistikore të dëmeve njerëzore gjatë Luftës së Dytë Botërore të vendeve të Evropës. Hedhja e tabelës në grafikë dhe interpretimi i saj).
Qytetërimet në antikitet dhe në mesjetë	
Qytetërimi në parahistori	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë numrat e shifrat romake për leximin dhe shkrimin e shekujve; • të përdorë boshtin numerik për interpretimin e shkallës së kohës. (Vendos në boshtin numerik vitet para Krishtit dhe pas Krishtit.); • të kryejë veprime matematikore në vlerë absolute, në funksion të llogaritjes së kohës. P.sh., përcakton sa kohë ka kaluar nga periudha e vendosjes së Republikës Romake. (viti 409 para K deri sot).
HISTORI	GJUHË SHQIPE
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit, përfshirë atë historik; • të shprehë opinione, arsyeton, diskuton, argumenton dhe bën debate tërheqëse dhe argumentuese me tematikë historike; • të shkruajë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese me tematikë historike; • të përzgjedhë informacionin e duhur historik në një vëllim të caktuar; • të shfrytëzojë teknikat e duhura gjuhësore, për të shkruar një artikull historik; • të shfrytëzojë rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e një materiali historik; • të lexojë dhe të interpretojë burime të ndryshme historike në dialektet gjuhësore.
Qytetërimet në antikitet dhe në mesjetë	
Qytetërimi në parahistori	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë teknikat, hapat dhe strategjitë për leximin dhe shkrimin e një dokumenti apo materiali zyrtar dhe jo-zyrtar historik; • të dallojë në gjinitë e ndryshme letrare: ditarin,

	kujtimet dhe romanin historik.
HISTORI	LETËRSI
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të shfrytëzojë veprat letrare-artistike si burim informacioni historik. P. sh., nëpërmjet veprës së Homerit, njihet me organizimin shoqëror të jetës në antikitet. “Qytetërimi antik grek në veprën e Homerit”. të përdorë folklorin shqiptar si burim historik; të përdorë veprën e rilindësve për të vlerësuar rolin që luajtën ata në historinë e Shqipërisë. “Rilindësit-prodhim i epokës historike shqiptare”.
HISTORI	GJUHË E HUAJ
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të shfrytëzojë gjuhën e huaj si burim për interpretimin në gjuhën shqipe të një informacioni historik. (p. sh., nxënësit në një veprimtari praktike i kërkohet të gjejë informacion me temë “Perandor romak me origjinë ilire”, duke shfrytëzuar si mjet burimor internetin); të përdorë terminologjinë bazë historike në gjuhë të huaj. <p>Terminologjia bazë e historisë që i kërkohet anglishtes: History; civilization; state, nation; law; absolute monarchy; constitution; war; king; queen; time; place; religion; government; evidence; World War I/II; empire; expirer; ancient; BC (before Christ); AC (after Christ); medieval; century.</p>
HISTORI	TIK
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të shfrytëzojë simbolet për shkrimin e shekujve me shifra romake në kompjuter. të përdorë <i>word-processor</i>-in për shkrimin e një materiali historik. të përdorë <i>Power Point</i>-in për prezantimin e një detyre në histori. të ndërtojë tabela, grafikë e diagrame në kompjuter, për të paraqitur me anë të tyre të dhëna të ndryshme historike. (p. sh. vendosja në tabela, diagrame e grafikë e të dhënave statistikore materiale dhe njerëzore të vendeve të Evropës për periudhën e Luftës së Dytë Botërore.); të përdorë internetin për nxjerrjen e të dhënave për ngjarje dhe figura historike.
HISTORI	GJEOGRAFI
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të shfrytëzojë mjetet mësimore gjeografike si harta,

	<p>globi dhe busulla për lokalizimin e territoreve ku kanë lindur dhe janë zhvilluar ngjarjet historike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë dhe të interpretojë harta të ndryshme historike dhe gjeografike; • të orientohet në hapësirë nëpërmjet hartës dhe globit, për të lokalizuar një territor të caktuar me vlera historike; • të përcaktojë në hartë vendndodhjen e qytetërimeve. Argumenton rëndësinë e relievit dhe të klimës në zhvillimin e qytetërimeve; • të përshkruajë teorinë e formimit të Tokës, për të argumentuar tezën e formimit të Tokës nga pikëpamja shkencore; • të përkufizojë dhe të shpjegojë termat migrim i jashtëm dhe i brendshëm i popullsisë, për të treguar lëvizjet e popujve dhe pasojat që ato sjellin në qytetërimi, gjatë periudhave të ndryshme të historisë.
Qytetërimet në antikitet dhe në mesjetë	
Historia e qytetërimit	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojë ç'është mjedisi gjeografik, për të kuptuar ndikimin e tij në zhvillimin e qytetërimeve;
Qytetërimet në antikitet dhe në mesjetë	
Qytetërimet e hershme. (Mijëvjeçari IV – II pr. K)	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojë veçoritë e lumenjve Tigër, Eufrat dhe Nil, si bazë për lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve në luginat lumore.
Qytetërimet në antikitet dhe në mesjetë	
Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojë veçoritë e detit Mesdhe, si bazë për lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve në brigjet e deteve.
HISTORI	QYTETARIA
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përkufizojë dhe shpjegojë konceptet liri, barazi, të drejta, ligj, komb, shtet, etni, demokraci dhe kushtetutë, për të shpjeguar zhvillimin historik të qytetërimeve; • të analizojë dhe interpretojë organizimin e familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhave historike; • të shpjegojë dhe analizojë format e sistemeve të qeverisjes, për të shpjeguar organizimin shtetëror gjatë periudhave historike; • të analizojë dhe interpretojë besimet e ndryshme fetare

	(politeizmi, monoteizmi, krishterimi, islamizmi) për të shpjeguar rolin e fesë në histori.
--	--

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare në lëndën “Historia e qytetërimit botëror”.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të nxënë, çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

P.sh., le të marrim te “Historia e qytetërimit botëror” klasa e 10-të, objektivin:

Nxënës/i-ja duhet të jetë i/e aftë “të ndërtojë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike”. Ky objektivi do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia të ushtrohen për ndërtimin e linjës së kohës dhe për vendosjen në këtë linjë të periudhave historike.

Një objektivi përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh., le të marrim te “Historia e qytetërimit botëror” klasa e 10-të, objektivin:

Nxënës/i-ja duhet të jetë i/e aftë “të përdorë një gjerësi burimesh historike dhe informacioni të duhur, duke përfshirë dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, medie, piktura, muze, galeri, fotografi, muzikë dhe internetin si bazë hetimi vetjak, për ndërtimin dhe argumentimin e një ngjarjeje historike”.

Të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të përdorin burimet historike dhe ato të informacionit, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i përvetësimit të këtij koncepti historik. Një nivel arritjeje është grumbullimi, përzgjedhja dhe kuptimi i materialit historik. Një nivel më i lartë se ky është interpretimi i këtij materiali historik në kontekstin e njohurive të marra. Një nivel edhe më i lartë do të ishte gjykimi për të, duke mbajtur qëndrim personal, bazuar në argumente dhe duke parashikuar perspektivat e së ardhmes.

Orët mësimore

Programi i historisë së qytetërimit botëror, në klasën e 10-të të arsimit profesional trajton “Historinë e Qytetërimeve në antikitet dhe në mesjetë”, që zhvillohet në **36 orë mësimore vjetore (36 javë x 1 orë mësimore/javë)**, prej të cilave afërsisht **26 orë** njohuri të reja dhe 10 orë përpunim njohurish, pra në raportin 70% njohuri të reja kundrejt 30% përpunim njohurish (përsëritje, teste, veprimtari praktike, projekte kurrikulare). Programi ka natyrë tematike-kronologjike dhe është strukturuar në linja dhe

nënlinja, që vijën njëra pas tjetrës. Linja nënkupton tematika të gjera historike, ndërsa nënlinjat nënkuptojnë zbërthimin e këtyre tematikave (linjave) në kapituj (nënlinja).

Në linjën e parë, “Qytetërimi në parahistori”, nxënës/i-ja mëson si ta vërë veten në pozitën e një historiani, si një eksplorues dhe mbledhës faktesh e dokumentesh, si përzgjedhës, gjurmues (kërkues/hetues), vlerësues dhe parashikues, i aftë për të mbajtur qëndrimin e tij/saj për ngjarje të ndryshme historike, duke u bazuar në burime historike. Vetëm në këtë linjë ndryshon raporti ndërmjet njohurive të reja dhe veprimtarive praktike, në favor të këtyre të fundit.

Veprimtaritë praktike shërbejnë për t’u ardhur në ndihmë nxënësit dhe mësuesit në orët e përpunimit, me raste sugjerimi për çështje të ndryshme historike, në lidhje me thellimin dhe përpunimin e njohurive dhe të shprehive të fituara në lëndën e historisë, duke e vënë nxënësin në qendër për mbledhjen dhe interpretimin e informacionit. Nëpërmjet veprimtarive praktike duhet të integrohet historia e qytetërimit të popullit shqiptar me historinë e qytetërimit botëror, duke inkuadruar ngjarjet e historisë së popullit shqiptar në ngjarjet e historisë botërore, nëpërmjet periodizimit të historisë.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës; ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të nënlinjës, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore);
- testimin e njohurive-bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit atyre u duhet kushtuar kohë e posaçme);
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve. Gjatë përpunimit të njohurive duhet t’i kushtohet kohë e posaçme veçanërisht kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme, si: e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- aftësive të posaçme lëndore, si: forcimi i personalitetit, edukimi i karrierës, aftësia për të vendosur në kohë dhe hapësirë ngjarjet historike, aftësia për të kuptuar, analizuar dhe argumentuar lidhjet shkak–pasojë, aftësia për të hetuar, interpretuar dhe parashikuar ngjarje historike, aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit si mjet burimor, aftësia për punë kërkimore, punë në grup etj.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të realizojnë detyra tematike, veprimtari praktike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah konceptet dhe të përforcojë shprehitë dhe qëndrimet e nxënësve.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes, që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit, nuk janë vetëm njohuritë dhe shprehitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësuesi i historisë vlerëson me notë apo me stimul shkallën dhe dinamikën e pjesëmarrjes së nxënësve në procesin mësimor. Mësuesi, gjithashtu, vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësi, aftësinë e tij për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrimin e tij personal ndaj një ngjarjeje apo figure të caktuar historike. Në lëndën e historisë mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup dhe për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.

Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është dhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produkteve të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një ese-je, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje apo figurë të caktuar historike, projekte etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes mirë të detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga mini-testet pak minutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënit, tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera, albume, ese, artikuj publicistikë etj.

Portofoli i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh..., të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar vlerësimin me shkrim ose me gojë.